VENDIM
Nr.153, datë 22.3.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pika 3, e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "b" të pikës 1 të kreut II "Rregullat e përgjithshme të prokurimit" të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, vlera e përllogaritur e blerjes, për çdo artikull, brenda një viti kalendarik, të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar.

Për mallrat dhe shërbimet, që lidhen me protokollin e institucioneve të larta shtetërore, konkretisht për:

- dhuratat që ato japin, për delegacionet e huaja gjatë vizitave zyrtare të tyre në Shqipëri;
- kurorat dhe buqetat me lule, për ceremonitë protokollare;
- shërbimin e dekorit të qytetit, mjediseve, të jashtme dhe të brendshme, të tyre;
- shërbimin e qiramarrjes së automjeteve nga Parku i Delegacioneve;
- mallra dhe shërbime për organizimin e konferencave, workshopeve, seminareve, tryezave të rrumbullakëta dhe takimeve të ndryshme të tyre.

Për artikujt protokollarë, që i shërbejnë veprimtarisë së përditshme të tyre, vlera e përllogaritur e blerjes, për çdo artikull, brenda një viti kalendarik, të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar.".

2. Paragrafi i fundit i shkronjës "b" të pikës 3 të kreut VII "Kohëzgjatja e kontratës", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kontraktori kërkon kohë për të rikuperuar koston e financimit (si për shembull grumbullimi dhe trajtimi i mjeteve urbane, shërbimet e kateringut në komplekse spitalore, shërbimet e transportit urban apo kontrata të ngjashme me to). Kohëzgjatja e këtyre kontratave nuk duhet të kalojë 7 vjet.".

3. Pas kreut XI shtohet kreu XII, me këtë përmbajtje:

"KREU XII
DISPOZITA TRANZITORE

Autoritetet kontraktore, për plotësimin e nevojave, në fillim të vitit, deri sa të kryhen procedurat e prokurimit, lejohen të përdorin procedurën me negociim pa njoftim, në përputhje me pikat 3, shkronja "b", e 5, shkronja "a", të nenit 33, të LPP-së, për kontratë shtesë me kontraktuesit e tyre të fundit, për mallrat apo shërbimet, me afat, deri në 30 maj 2007. Fondet për këto kontrata të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion në buxhetin e këtij viti, për të njëjtin shërbim apo mall.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha